



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: 06.01.2026		
Prilajeno:		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-453/01-469		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Drejtoresha e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, me Seli në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në fushën e rinisë.

1. Ky institucion ofron mbështetje financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve Implementimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit.
2. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një(1) projekt që kontribuojnë në **Implementimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Lipjanit. si dhe implemetimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit .**
3. Vetëm për një (1) vit.
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 38,000.00 €

Mjetet do te terhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike.

5. Përfitues do të jetë një (1) OJQ për Implementim të Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Lipjanit 2025-2030. si dhe implemetimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 në Komunën e Lipjanit.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501.00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 38.000,00 €.

6. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 27.01.2026

7. OJQ-të mund të aplikojnë me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është 1 vjeçar.

- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

- OJQ aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e rinisë.

- OJQ duhet të dëshmojë paku 1 Referencë për punë të ngjashme në vitet e më parshme.

- OJQ- të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

- Para nënshkrimit të kontratës, duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ i ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net

Lipjan, 05.01.2026

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës

